VENDIM
Nr.166, datë 28.3.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS "ROT", TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË E MINISTRISË SË INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "AMAL" SHPK, PËR HIDROCENTRALIN VENDOR TË XHYRËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.486, DATË 10.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit të formës "ROT", të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "AMAL" sh.p.k., për hidrocentralin vendor të Xhyrës, të miratuar me vendimin nr.486, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.486, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe në tekstin e marrëveshjes bazë të koncesionit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "AMAL" sh.p.k., për hidrocentralin vendor të Xhyrës, fjalët "…Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës…" zëvendësohen me "…Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës…".

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHTESË KONCESIONI
PËR HIDROCENTRALIN XHYRË

Në Tiranë, sot më 14.3.2007, Palët:

OSHA, e përfaqësuar nga z.Zamir Stefani, me autorizimin nr.115/1, datë 22.2.2007 të METE-s

dhe

Shoqëria "AMAL" sh.p.k., Librazhd, përfaqësuar nga z.Arjan Hysenllari, me prokurën e posaçme, nr.rep.608, kol.1442, datë 14.12.2006,

me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Marrëveshje shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë "AMAL" sh.a., Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Xhyrës në Librazhd, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003.

HYRJE

Duke pasur parasysh që në marrëveshjen ekzistuese të koncesionit ka gabime teknike dhe mangësi në funksion të zbatimit të penaliteteve, për të realizuar monitorimin e duhur të ecurisë së objektit të koncesionit, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes.

Palët bien dakord që në marrëveshjen bazë të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Te titulli, rreshti i tretë i marrëveshjes së koncesionit e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë "AMAL" sh.p.k. Librazhd, për rehabilitimin e hidrocentralit të Xhyrës në Librazhd, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003 bëhet:

"Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës", më poshtë referuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).".

Neni 2

Në nenin 4 "Detyrimet e koncesionarit":

- te paragrafi i parë, pika 2, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë: "Në hidrocentralin e Xhyrës, investimi prej 5.45 milionë lekë do të përfundojë brenda datës 30.6.2007";

- në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Me përfundimin e zbatimit të projektit rehabilitues mbi objektin e koncesionit, koncesionari është i detyruar që në fund të çdo tremujori, dhe sa herë e kërkon OSHA-ja, të raportojë me shkrim mbi ecurinë e punës në objekt sipas një formulari që do të dërgohet nga OSHA-ja.".

Neni 3

Në nenin 9 "Programi i punimeve", pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2007 deri në fund të periudhës koncesionare, do të jetë jo më pak sesa prodhimi i përcaktuar në aneksin 1 në kolonën: viti 2005.

Ndryshimi i programit vjetor i prodhimit mund të bëhet me miratim të OSHA-së, në rastet e ndryshimit të parametrave teknikë të objektit.

Neni 4

Në nenin 14 "Kontrolli i përgjithshëm", pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"OSHA-ja ushtron kontroll në objektin e dhënë me koncesion edhe gjatë kohës së shfrytëzimit, pas përfundimit të rehabilitimit të përcaktuar në këtë Marrëveshje. Kontrolli kryhet nga persona të autorizuar nga OSHA-ja me qëllim që të verifikojë shfrytëzimin dhe prodhimin, sipas parametrave teknikë të objektit të dhënë me koncesion, si dhe kryerjen e remonteve të parashikuara në udhëzimet e shfrytëzimit të pajisjeve.".

Neni 5

Në nenin 20 "Sanksionet":

- paragrafi i dytë i këtij neni bëhet:

"Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 9, pika 2 të marrëveshjes së koncesionit "Programi i punimeve", koncesionari do t'i paguajë OSHA-së, për çdo ditë vonesë,penalitetin 0,01% të vlerës së investimit të parealizuar, për çdo program rehabilitimi";

- pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rast mosrealizimi të programit të prodhimit, të përcaktuar në nenin 3 të kësaj

Marrëveshjeje, koncesionari penalizohet me 0,01% të vlerës së prodhimit të parealizuar për periudhën raportuese.”.

Neni 6

Marrëveshja shtesë e koncesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet e përshkruara në nenet 1-6 më lart, kanë fuqi për të dyja Palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes bazë nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja shtesë e koncesionit mbahet në 7 (shtatë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja Palët.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
PËRFAQËSUESI ME AUTORIZIM
Zamir Stefani

Për koncesionarin
Shoqëria “AMAL” sh.p.k.
PËRFAQËSUESI ME PROKURË
Arjan Hysenllari